



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË  
V E N D I M

Nr. 39 dt.27.03.1996

**MBI**  
**REALIZIMIN E TË ARDHURAVE PËR VITIN 1995**  
**PLANIFIKIMIN DHE PËRDORIMIN E TYRE PËR VITIN 1996**

Këshilli Bashkiak, i mbledhur sot me dt.27.03.1996, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Drejtoria e Administrimit Financiar mbi planifikimin dhe përdorimin e të ardhurave për vitin 1996

V E N D O S I

1. Të miratojë realizimin e të ardhurave për vitin 1995 për **191.181 mijë lekë**.
2. Të miratojë mbartjen e fondeve të pa përdorura për vitin 1995 në vitin 1996 për **62.411 mijë lekë** nga të cilat shuma prej **37.418 lekë** të çelet sipas miratimeve të bëra për llogari të vitit 1995(si lista bashkalidhur).
3. Të miratojë mbulimin e shpenzimeve operative të institucioneve në vartësi të pushtetit lokal nga të ardhurat e Bashkisë si më poshtë vijon :

**1.Aparati i Bashkisë                                      22.040 lekë**

**2.Administrata Arsimit                                      9.340 lekë**

<b>3.Drejtoria e Çerdheve</b>	<b>21.695 lekë</b>
<b>4.Ndërm.Ndriçimit Publik</b>	<b>15.199 lekë</b>
<b>5.Ndërm. Tregut të Lirë</b>	<b>30.480 lekë</b>
<b>6.D.D.D.</b>	<b>680 lekë</b>
<b>7.Ndërm. Konservim</b>	<b>3.000 lekë</b>
<b>8.Ndërm. Kuartalleve</b>	<b>14.420 lekë</b>

---

**Shuma      116.854 lekë**

4. Të miratojë fondin prej **25 milion lekë** për investimet të Tregut të Lirë brenda të ardhurave të realizuara nga kjo ndërmarrje (ndërtim tregu në lagjen Nr.8 për **lekë 4.5 milion**, tregu artikujve elektroshtëpiake **10 milion lekë**, ofiçina riparimit mjeteve për **4 milion lekë**, tregu fruta perime porcelan **3 milion lekë**, studime **1.5 milion lekë**, blerje makineri **2 milion lekë**)
5. Ngarkohen Seksionet Operative dhe Drejtoria e Administrimit Financiar për detajimin e fondeve të mësipërme në nivel artikulli dhe për çdo 4 / mujor.
6. Ngarkohet aparati Bashkisë për ndryshimin e destinacionit të investimeve për Ndërmarrjen e Tregut të Lirë brenda fondit të miratuar.
7. Çelja e fondeve të mësipërme do të bëhet krahas realizimit të të ardhurave.
8. Ngarkohet Drejtoria e Administrimit Financiar për rishpërndarje të fondeve brenda institucioneve për të cilat është bërë planifikimi.
9. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**BESNIK PETRELA**